



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2662/11 prot.,

Datë 04.11.2025

V E N D I M
Nr. 1599/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 04.11.2025 shqyrtoi ankesën me:

- Objekt:** Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 1490/2025, datë 21.10.2025 për procedurën e prokurimit prokurimit “E Hapur e Thjeshtuar”, me Nr. REF-58861-08-22-2025, me objekt: “Blerje materiale elektrike per reabilitimin e ndricimit te aksit rrugor Shkoder - Mes”, me fond limit 8,164,336.12(Tetë milion e njëqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e treqind e tridhjetë e gjashtë pikë dymbëdhjetë) lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 04.09.2025 nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Shërbimeve dhe Punëve Publike, Shkodër.
- Ankimues:** Operatori ekonomik Ervin Luzi me Nipt K71707007Q dhe adresë: Lagjja Katund i Ri, Rruga Ali Pashe Gucia, Godina nr.5, Tiranë
- Autoriteti Kontraktor:** Ndërmarrja e Shërbimeve dhe Punëve Publike
Lagjia Tre Heronjte, Shkodër
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për

Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 21.10.2025, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 1490/2025, ku vendosi:

[.....]

1. *Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik Ervin Luzi për procedurën e prokurimit “prokurimit “E Hapur e Thjeshtuar”, me Nr. REF-58861-08-22-2025, me objekt: “Blerje materiale elektrike per reabilitimin e ndricimit te aksit rrugor Shkoder - Mes”, me fond limit 8,164,336.12(Tetë milion e njëqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e treqind e tridhjetë e gjashtë pikë dymbëdhjetë) lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 04.09.2025 nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Shërbimeve dhe Punëve Publike, Shkodër*
2. *Autoriteti Kontraktor të rishikojë arsyet e skualifikimit për operatorin ekonomikë ankimues sipas konstatimeve të këtij vendimi.*
3. *Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.*
4. *Ngarkohet zyra e financës, të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar operatori ekonomik të paguar nga operatori ekonomik Ervin Luzi.*
5. *Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
6. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.” [...]

I.2. Me shkresën nr. 2322/1 prot., datë 28.10.2025, protokolluar me tonën nr. 2662/8 prot., datë 31.10.2025, autoriteti kontraktor Ndërmarrja e Shërbimeve dhe Punëve Publike, Shkodër, njofton se ka zbatuar vendimin e KPP-së Nr. 1490/2025 datë 21.10.2025.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1. Me shkresën nr. 2322/1 prot., datë 28.10.2025, protokolluar me tonën nr. 2662/8 prot., datë 31.10.2025, autoriteti kontraktor Ndërmarrja e Shërbimeve dhe Punëve Publike, Shkodër, njofton se ka zbatuar vendimin e KPP-së Nr. 1490/2025 datë 21.10.2025.

II.2. Nga verifikimi i raportit të auditit në sistemin e prokurimit elektronik, KPP konstaton se autoriteti kontraktor nuk e ka kryer rivlerësimin e procedurës në sistemin e prokurimit elektronik në përputhje me vendimin e KPP Nr. 1490/2025 datë 21.10.2025. Në raport audit operatorit ekonomik Ervin Luzi rezulton i skualifikuar me të njëjtat arsye të dhëna nga KVO-ja dhe jo sipas konstatimeve të KPP.

Përsa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenin 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E Hapur e Thjeshtuar”, me Nr. REF-58861-08-22-2025, me objekt: “Blerje materiale elektrike për reabilitimin e ndricimit të aksit rrugor Shkodër - Mes”, me fond limit 8,164,336.12 (Tetë milion e njëqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e treqind e tridhjetë e gjashtë pikë dymbëdhjetë) lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 04.09.2025 nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Shërbimeve dhe Punëve Publike, Shkodër.
2. Autoriteti kontraktor të zbatojë plotësisht përcaktimet e vendimit Nr. 1490/2025 datë 21.10.2025, të Komisionit të Prokurimit Publik.
3. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiovent Zguro

